



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria për Prokurim Publik

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të **Op. Ek. "AtomMed O.P" me seli në Ferizaj**, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar me **dt.23.05.2023**, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, **më datën 14.08.2023** merr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë: **"AtomMed O.P" me seli në Ferizaj**, e datës **02.08.2023**, për rishikimin-rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër **Vendimit mbi Njoftimin e Autoritetit Kontraktues të datës 23.05.2023** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizimi me paisje mjekësore sipas LOT1 dhe LOT2"** me nr. të prokurimit: **Nr. Prok: VU644 – 23 – 5195 – 1-2-1, Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 062 – 121.**
2. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së do të vazhdoj me rivlerësim të aktivitetit të prokurimit.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik ka marrë vendim që në aktivitetin e prokurimit: **"Furnizimi me paisje mjekësore sipas LOT1 dhe LOT2"** me nr. të prokurimit: **VU644 – 23 – 5195 – 1-2-1, Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 062 – 121**, të shpërblej me kontratë për LOT1 Operatorin Ekonomik: **"BIO-LAB" sh.p.k. me seli në Gjilan.**

Në Kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga Op. Ek. **"AtomMed O.P" me seli në Ferizaj**, (në tekstin e **mëtejme Ankuesi**), e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e LPP-së, neni 69, si dhe nenet 26, 40.2 dhe 43.1 të RrPP-së.


Pasi u shqyrtuan pretendimet e Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimet të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit është pjesërisht e bazuar.

Lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës tek **"Specifikat teknike"** për pajisjet e ofertuara nuk i plotëson specifikat e kërkuara në Dosjen e Tenderit, specifikisht tek pajisja hematologjike SWELAB, te pajisja Imunologjike YHALO, ndërsa te aparati urinar, pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

Prandaj A.K. këto pretendime i konsideron si të qëndrueshme, dhe çështjet e ngritura do t'i marrë në rishqyrtim gjatë procesit të rivlerësimit të tenderit në fjalë.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 062/2023, datë 02.08.2023

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik



Alban Tahiraj

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Vendimi i dërgohet nga një kopje:

1. Palës/ ve;
2. DPP-së, dhe
3. Arkivit.